



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURENCËS

### Njoftim Për Shtyp

**Rasti:** Krijimi i një ndërmarrje të re, të përbashkët, me funksione të plota (Joint Venture Sensia) nga shoqëritë Rockwell Automation Diamond Holdings Inc., Rockwell Automation Diamond Foreign Holdings Inc., Schlumberger Technology Corporation, Cameron International Corporation dhe Schlumberger B.V.

Autoriteti i Konkurrencës me shkresën Nr. 205 Prot., protokoll i AK, datë 15.03.2019 “Përqendrimi ndërmjet Rockwell Automation Diamond Holdings Inc. dhe Rockwell Automation Diamond Foreign Holdings Inc. nga njëra anë dhe Schlumberger Technology Corporation, Cameron International Corporation dhe Schlumberger B.V nga ana tjetër, për përfitim të kontrollit të përbashkët të shoqërisë joint venture që do të krijohet rishtas që do të quhet Sensia”, është njoftuar në lidhje me transaksionin që konsiston në krijimin e një ndërmarrje të përbashkët (joint venture) me funksione të plota.

**Rockwell Automation Diamond Foreign Holdings Inc.**, është një shoqëri e krijuar sipas legjislacionit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, e kontrolluar drejtpërdrejtë nga Rockwell Automation INC.

**Rockwell Automation Diamond Holdings Inc.** është një shoqëri e krijuar sipas legjislacionit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, e kontrolluar drejtpërdrejtë nga Rockwell Automation INC.

**Schlumberger Technology Corporation**, është një shoqëri e krijuar sipas legjislacionit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Aktiviteti kryesor i saj është ai në fushën e shërbimeve të naftës.

**Cameron International Corporation**, është një shoqëri e krijuar sipas legjislacionit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës e cila ofron produkte të pajisjeve të rrjedhjes, sisteme dhe shërbime të industrisë së naftës dhe gazit në mbarë botën.

**Schlumberger B.V.**, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e krijuar sipas legjislacionit të Hollandës. Objektivi i kësaj shoqërie është të veprojë si shoqëri e ndërmjetme holding dhe financiare dhe të ofrojë shërbime administrative dhe menaxhimi për shoqëritë e grupit, si dhe të angazhohet në kërkime shkencore dhe aktivitete inxhinierike.

Palët e mësipërme do të krijojnë një shoqëri të përbashkët, me funksione të plota (joint venture), të quajtur **Sensia**.

**Sensia** do të jetë një shoqëri e krijuar rishtaz sipas legjislacionit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, me objekt aktiviteti në ofrimin e automatizimit të integruar dixhital dhe të zgjidhjeve informative për klientët në industrinë globale të Naftës dhe Gazit Natyror.

Në datën 15 Shkurt 2019 është nënshkruar dokumenti i “Marrëveshjes së Formimit Master”, ndërmjet shoqërive Rockwell Automation Diamond Holdings Inc., Rockwell Automation Diamond Foreign Holdings Inc., Schlumberger Technology Corporation, Cameron International Corporation dhe Schlumberger B.V, të cilat kanë rënë dakort që të krijojnë një ndërmarrje të përbashkët, me funksione të plota (joint venture), të quajtur Sensia.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Si pasojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

**Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën [competition@caa.gov.al](mailto:competition@caa.gov.al).**